

Trajnime për profesionet e tjera të lira

14. Trajnimet për profesionet e tjera të lira

Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022 si dhe kërkesat e profesioneve të lira drejtuar Akademisë së Drejtësisë është hartuar përmbajtja sa i përket kurrikulës trajnuese për zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, përmbaruesit privat si dhe për mbrojtësit e viktimave. Po ashtu bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues nr. Nr.01/485/019 të datës. 27.11. 2019 do të ofrohet mundësia e përfshirjes në trajnime të avokatëve shtetëror në trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë në tematikat për të cilat ata kanë nevojë.

Në kuadër të kurrikulës trajnuese për zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas do të trajtohen temat si në vijim:

- ✓ Praktika gjyqësore në drejtën pronësore
- ✓ Barazia gjinore në çështjet pronësore të pronësisë së përbashkët
- ✓ Praktika gjyqësore në konteste e punës
- ✓ KEDNJ dhe praktika gjyqësore
- ✓ Procedura e provave dhe mjetet e jashtëzakonshme në procedurë civile

Në kuadër të kurrikulës trajnuese për mbrojtësit e viktimave do të trajtohen temat si në vijim:

- ✓ Dhuna në Familje – ndryshimet e ligjit
- ✓ Kompensimi i viktimave – ndryshimet e ligjit
- ✓ Trafikimi me qenie njerëzore, detyrimi në prostitucion, keqtrajtim seksual, dhunime etj
- ✓ Trajnim me përvoja praktike për rastet e vrasjeve dhe grabitjeve.

Në kuadër të kurrikulës trajnuese për përmbaruesit privat do të trajtohen temat si në vijim:

- ✓ Dorëzimi i shkresave ne procedure përmbarimore
- ✓ Përmbarimi përmes llogarive bankare- unifikimi akteve
- ✓ Depozitimi i garancionit bankar